**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.**

Nr.601/6 prot. Korçë, më 04.06.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**
"Ruajtja e objekteve të UKRK Sh.A me punonjës shërbimi, sistem alarmi, kamera dhe ruajtja e shoqërimi i vlerave monetare" –Marreveshje Kuader, - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**): 79713000-5 Shërbime roje/shërbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT:
Fondi limit/ vlera e pritshme e kontratës: 34.244.429
(tridhjetëekatërmilionedyqindedyzetekatërmijëekatërqindenjëzetenëntë) lekë pa TVSH.
Shumatorja e çmimeve për njësi është : 2.853.702,44
(dymilionetetëqindepesëdhjetëetremijëeshtatëqindedypresjedyzetekatër) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
*a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.*
*b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 684.888,58 (gjashtëqindetetëdhjetëekatërmijëe tetëqindetetëdhjetëetetëpresjepesëdhjetëetetë) lekë (2% të vlerës së përllogaritur të kontratës).*

K. Dishnica A. Minerali E. Bicolli

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 17.122.215 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndyshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) **vlerën e përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.**

**Brenda këtij kufiri , me qëllim nxitjen e konkurrencës është kërkuar vlera e xhiros që të jetë minimalisht sa 50% e vlerës së pritshme të kontratës: 34.244.429 x 50%= 17.122.215 leke.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet , *kur përmasat nuk dihen*, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,

**2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 13.697.771 lekë pa TVSH .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ( 40% x 34.244.429 leke= 13.697.771 leke) . Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

A. Minerali

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të vlefshme të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit "Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike", nënkategoria (kodi) 1.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimtarive social - kulturore, sportive fetare e politike", lëshuar nga QKB.

***Argumentimi****:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe

Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VKM Nr.538, datë 26.5.2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri lidhur me licencat profesionale dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;
b. Llojin e shërbimeve të parashikuara
c. Përshkrimin e shërbimeve konkrete të parashikuara për t'u realizuar në specifikimet teknike;
d. Kategoritë e shërbimeve dhe përshkrimin e tyre që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në aktet ligjore të sipërpërmendura.

Bazuar në sa më sipër kërkohet Nënkategoria I.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike".

A. Minerali

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të vlefshme të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit “Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike”, për nënkategorinë (kodi) 1.3.B "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare gjatë transportit", lëshuar nga QKB.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe

Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VKM Nr.538, datë 26.5.2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri lidhur me licencat profesionale dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;
b. Llojin e shërbimeve të parashikuara
c. Përshkrimin e shërbimeve konkrete të parashikuara për t’u realizuar në specifikimet teknike;
d. Kategoritë e shërbimevedhe përshkrimin e tyre që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në aktet ligjore të sipërpërmendura.

Bazuar në sa më sipër kërkohet Nënkategoria I.3.B, “Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit”, pasi kërkohet sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare të Zyrës me Marrëdhënien me Konsumatorin të UKRK SH.A.

A. Minerali

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

2.2.4. Çertifikatë për Drejtues Teknik Subjekti, e vlefshme, në fushë e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, për nënkategorinë 1.3.A, si dhe për nënkategorinë 1.3.B, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe

Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Çertifikatat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri lidhur me Çertifikatën dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;
b. Llojin e shërbimeve të parashikuara
c. Përshkrimin e shërbimeve konkrete të parashikuara për t'u realizuar në specifikimet teknike;
d. Kategoritë e shërbimeve dhe përshkrimin e tyre që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në aktet ligjore të sipërpërmendura.

Për :

Nënkategorinë I.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", bazuar në shërbimin për ruajtjen e objekteve të UKRK SH.A.

Nënkategorinë I.3.B, "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", bazuar në shërbimin sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare të Zyrës me Marrëdhënien me Konsumatorin të UKRK SH.A.

A. Minerali

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

2.2.5. Çertifikatë për Për Titullar Subjekti, e vlefshme, në fushë e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, për nënkategorinë 1.3.A, si dhe për nënkategorinë 1.3.B, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe

Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Çertifikatat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri lidhur me Çertifikatën profesionale dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;
b. Llojin e shërbimeve të parashikuara
c. Përshkrimin e shërbimeve konkrete të parashikuara për t'u realizuar në specifikimet teknike;
d. Kategoritë e shërbimeve dhe përshkrimin e tyre që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në aktet ligjore të sipërpërmendura.

Për :

Nënkategorinë I.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", bazuar në shërbimin për ruajtjen e objekteve të UKRK SH.A.

Nënkategorinë I.3.B, "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", bazuar në shërbimin sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare të Zyrës me Marrëdhënien me Konsumatorin të UKRK SH.A.

A. Minerali

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

2.2.6. Autorizim Individual të Subjektit, për caktim dhe përdorim frekuencash për sisteme **radiokomunikimi** , si dhe sisteme **radioalarmi,** me zonë shërbimi e cila mbulon zonën ku ndodhen objektet e UKRK Sh.A, lëshuar nga AKEP.

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" me ndryshime, si dhe

Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime,

Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".:" që përcakton se citojmë: "Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike që ka në ruajtje objekte me sisteme elektronike, duhet të pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual."

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizimet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kriteri lidhur me Autorizimet profesionale dhe kategoritë e saj është në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Autorizimi kërkohet për :
Sisteme radiokomunikimi;
Sisteme radioalarmi .
*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënllojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

2.2.7. Çertifikatë e regjistrimit me numrin unik te identifikimit, të lëshuar nga QKB që subjekti i regjistruar ushtron veprimtari në Qarkun e Korçës .

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, si dhe

Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Bizneseve" nenin 62, paragrafi 2,

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

A. Minerali

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Çertifikatën e regjistrimit si subjekt i regjistruar që ushtron veprimtari në Qarkun e Korçës , të lëshuar nga autoriteti kompetent QKB.

2.2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor,** si më poshtë:

a. Dy Drejtuesit teknik për dy kategoritë e shërbimeve të kërkuara 1.3.A dhe 1.3.B

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. 38 punonjës shërbimi të çertifikuar.

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK,***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- *Çertifikata për punonjësit e shërbimit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, për nënkategorinë 1.3.A, për të paktën 38 punonjës shërbimi , si dhe nga këta të paktën dy të kenë edhe nënkategorinë 1.3.B, çertifikata këto të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Korçë.*
  *Ndësa Çertifikata për Drejtues Teknik Subjekti është kërkuar më sipër tek pika 2.2.4.*

- *Vërtetim nga Drejtoria e Policisë të Qarkut Korçë, që të vërtetojë në mënyrë të qartë që ofertuesi ka të liçensuar, minimumi 38 punonjës shërbimi;*

A. Minerali

Shoqëria private e sigurisë fizike, për realizimin e detyrës, në varësi me specifikat e shërbimit pajis punonjësit me: armatim personal, në përputhje me parashikimet e Ligjit “Për armët”.

Rregullat për mbajtjen, administrimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit, nga punonjësit e SHPSF-së janë sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar. kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

**Argumentimi**: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe

Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,

Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike",

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se punonjësit e shërbimit disponojnë Çertifikatat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoriteti kompetent, në përputhje kjo me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me shërbimet e kërkuara të kontratës .

Konkretisht:

Sipas Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, operatorët ekonomikë duhet të kenë drejtuesin teknik dhe një administrator .

Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” , KREU I , pika 4 përcakton që: "Çdo subjekt ka të drejtë të përfitojë njëkohësisht licencat e nënkategorisë 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C, me kusht që për secilën nënkategori të ketë drejtues teknik më vete.” Për realizimin e shërbimeve të kontratës kërkohen dy nënkategori 1.3.A dhe 1.3.B dhe për këtë arsye subjekti duhet të ketë 2 drejtues teknik.

Numri 38 punonjës shërbimi të kërkuar Argumentohet si më poshtë:

Për 5 vend roje me shërbim 24 orë me tre turne të kërkuar llogariten : **5x 4,98 = 24,9**

Për 1 vend roje me shërbim 8 orë (ora 8:00-16:00) me një turn në ditet zyrtare të punës + ditën e shtunë nga ora 8.00 –12.00 , tek objekti Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), të kërkuar llogariten : **1 x 1,31= 1,31**

A. Minerali

Koeficienti 1,31 llogaritet si më poshtë:

Sipas rekomandimit të APP: ”Për shërbimin që do të kryhet me kohëzgjatje 12 muaj, rekomandojmë që shtesat të përllogariten për periudhën kohore 30,41 ditë në muaj. ”

Pra për periudhën kohore 30,41 ditë në muaj kemi për një vend roje 24 orë me tre turne : 4,98 punonjës shërbimi.

Ndërsa për një vend roje 8 orë (ora 8:00-16:00) me një turn në ditet zyrtare të punës + ditën e shtunë nga ora 8.00 –12.00 llogariten:

Koficienti i zëvendësimit për një muaj , për një turn I ( 8 orë shërbim) është 4,98:3 =1,66

Për një vend roje 8 orë me një turn, llogariten : 22 ditë pune në muaj (nga e hënë- të premte) +

2 ditë pune shtesë ( 4 orë të ditës së shtunë x 4 të shtuna =16 orë : 8 orë=2 ditë pune) = 24 ditë pune në total .

Koficienti i zëvendësimit për një ditë është : 1,66 : 30,41 ditë në muaj = 0, 054587307

0,054587307 x 24 ditë pune= 1,31 Koficienti i zëvendësimit për vendroje me një turn dhe sherbim 8 ore në ZMK.

Për 3 vend roje me shërbim 8 orë, turni i trete (ora 22:00-6:00) me një turn , të kërkuar llogariten : 3 x koficientin e i zëvendësimit për një muaj 1,66 (4,98:3) = 4,98 punonjës shërbimi

Ndërsa për sistemet e alarmit, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 datë 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" kreu V, pika 13 ku përcaktohet : " Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn.” , llogariten: 2 punonjës x 3 turne = 6 punonjës.

Për shërbimin : "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, gjatë transportit nga Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), në banka të nivelit të dytë”, kërkesa e AK, bëhet bazuar në :

Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” , KREU VI ,

- gërma ”B." Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit ”, pika:

A. Minerali

” 3. Subjektet SHPSF-ve të pajisura me licencë të nënkategorisë 1.3.B, që transportojnë vlera monetare, materiale…., përdorin **kurdoherë automjete të blinduara** që plotësojnë kushtet minimale teknike dhe të sigurisë……."

- gërma **"C" ”Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese ", pika 1**

”Për transportin e vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së përdoren automjete të blinduara sipas kategorizimit të mëposhtëm:
**1. Kategori A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë deri në 10.000.000 lekë realizohet me:**
a) Një automjet i blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):
- Niveli i blindimit të automjetit BR-3;
- Pjesa ku vendosen mbajtësit e vlerave monetare të jetë pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

**b) Jo më pak se dy punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti).**
c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së. ….."

Sasia maksimale-minimale e vlerave monetare që do të transportohen gjatë një eskortimi është deri 2.000.000 lekë.
**Pra për automjetin e blinduar duhen dy punonjës shërbimi :**

**Punonjësi i shërbimi që bën ruajtje në** objektit Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) e UKRK Sh.A, si dhe Një Punonjës shërbimi (shofer) i SHPSF-së për drejtimin e **automjetit të blinduar,** Kategoria A, sipas kategorizimit të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Kreu VI , gërma **"C", pika 1.**

**PRA GJITHSEJ LLOGARITEN : 24,9+ 1,31 + 4,98 + 6 + 1 ~ 38 PUNONJËS SHËRBIMI**

Kategoritë për punonjësit e shërbimi:

Nënkategorinë I.3.A duhet ta ketë çdo punonjës shërbimi i kërkuar .

Nënkategorinë I.3.B, , duhet te ketë minimalisht dy punonjës shërbimi : 1 roja i objektit Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) me shërbim 8 orë me një turn + një punonjës tjetër shërbimi drejtues mjeti për shoqërimin e vlerave monetare me mjetin e blinduar.

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

A. Minerali

2.2.9. Vërtetim nga Drejtoria e Policisë të Qarkut Korçë, që të vërtetojë në mënyrë të qartë që ofertuesi :

- ka grup të gatshëm punonjësish për verifikimin e sinjaleve të alarmit ;

- ka qendër kontrolli ( sallë operative) në Qytetin Korçë dhe adresën e saj ( të miratuar me Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit);
  KVO ka të drejtë dhe mund të kryejë verifikime të ekzistencës të qendrës të kontrollit (sallës operative) dhe të elementëve përbërës të saj , para marrjes së vendimit të vlerësimit të ofertave;

- ka performancë të mirë në ushtrimim e aktivitetit të operatorit ekonomik.

***Argumentimi****:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" me ndryshime, si dhe

Ligjin Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike",

Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike".:" që përcakton se citojmë: "Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike që ka në ruajtje objekte me sisteme elektronike, duhet të pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual."

Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime,

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Grupi i gatshëm kërkohet për verifikimin e sinjaleve të alarmit.

Qendra e kontrollit kërkohet në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" kapitulli V . Me Aktin e Miratimit për funksionimin e Qendrës së Kontrollit , të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Korçë miratohet nëse subjekti, gjendet i përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit , mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë të sigurisë fizike.

Referuar Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" dhe Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" kërkohet performancë e mirë në mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik mbi bazën e kritereve të përmbushjes së detyrës dhe konstatimeve për shkeljet administrative që do të shëbente si dëshmi në përmbushjen me sukses të kontratës nga oe.

A. Minerali

2.2.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht -41- persona.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.9.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK,***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

- *Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore(formularët E-sig 025 a), për periudhën kohore : Mars 2024 –Prill 2024 - Maj 2024, për punësimin e minimalisht 41 punonjës të siguruar në muaj, 38 punonjës shërbimi si dhe 2 drejtuesit teknik , si dhe administratorin (Titullarin e subjektit të SHPSF-së- përfaqësuesi ligjor i subjektit.)*

***Argumentimi**:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,

të Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike",

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

~38 punonjës shërbimi të llogaritur si më lart + 2 drejtues teknik +administrator =41 persona.

Specifikimi i shërbimeve që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, për numrin 40 të punonjësve të nevojshëm si dhe dy drejtuesit teknik analizohen me lart tek pika 2.2.8 e këtij procesverbali.

Periudha tre mujore Mars 2024 –Prill 2024 - Maj 2024 kërkohet si një periudhë kohore koherente.

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë *apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).*

A. Minerali

*2.2.11* Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të disponojë se paku një automjet, për ndërhyrje në raste emergjente.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë se paku një automjet **të blinduar,** Kategoria A, sipas kategorizimit të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Kreu VI , gërma **"C", pika 1. Për shërbimin** Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, gjatë transportit nga Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), në banka të nivelit të dytë.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.**

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK,***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit***,

- Për të dëshmuar që OE disponon se paku një automjet, për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera duhet të paraqesë:

- Aktin e Pronësisë të Automjetit;
- Leje e Qarkullimit te automjetit në pronësi të shoqërisë ;

Në rastin kur automjeti është marrë me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontraten noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.

- Për të dëshmuar që OE disponon se paku një automjet **të blinduar,** Kategoria A, sipas kategorizimit të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Kreu VI , gërma **"C", pika 1. Për shërbimin** Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, gjatë transportit nga Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), në banka të nivelit të dytë, duhet të paraqesë:

- Aktin e Pronësisë të Automjetit;
- Leje e Qarkullimit te automjetit në pronësi të shoqërisë ;
- Autorizimin e Mjetit të Blinduar, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Në rastin kur automjeti është marrë me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontraten noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.

**Argumentimi**: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , të nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,

të Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm Nr. 130 date 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike",

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

A. Minerali

OE duhet të disponojë se paku një automjet, për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera.
Gjithashtu OE duhet të disponojë se paku një automjet të blinduar, sipas detyrimit ligjor të cituar dhe analizuar në pikën 2.2.8 të këtij Procesverbali.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për *nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).*

**II. Argumentimi për mos ndarjen me lote të kontratës "Ruajtja e objekteve të UKRK Sh.A me punonjës shërbimi, sistem alarmi, kamera dhe ruajtja e shoqërimi i vlerave monetare" :**

Nisur nga fakti se fondi për këtë shërbim është një fond i cili për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A zë një vlerë të konsiderueshme në shpenzimet e kompanisë, duke bërë llogaritjen e vlerës së fondit dhe duke parë anën funksionale të ruajtje së objekteve e vlerave monetare mënyra jonë e llogaritjes ka marrë parasysh vetëm koston e drejtuesit të mjetit të blinduar për transportin e vlerave monetare nga zyra e marrëdhenieve me konsumatorin tek bankat e nivelit të dytë.

Kostoja e punonjësit të shërbimit të dytë (referuar Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike" , KREU VI , pika 1, gërma b **,** që bën shoqërimin e vlerave monetare me automjetin e blinduar përfshihet në koston e ruajtjes së objektit sepse kemi parashikuar që vetë punonjesi që bën ruajtjen e objektit do të shoqërojë mjetin me të cilin do të bëhet transporti i mjeteve monetare.
Pra ne kemi llogaritur një kosto minimale për shërbimin e transportimit të mjeteve monetare.

Ndarja e këtaj kontrate në lote çon në ritje të personelit. Kemi llogaritur një punonjës në dy funksione të tij: si roje objekti dhe si punonjës i grupit të transportimit të vlerave monetare për një orë në ditë për çdo ditë pune, për 22 ditë në muaj ,

Shtimi i një punonjësi (duke bërë përllogaritjen e orëve, ditëve, muajve) për transportin e vlerave monetare do të ndikojë në rritjen e kostos.

Kjo rritje e kostos shmanget nga ana jonë duke llogaritur të njëjtën shoqëri për të ofruar të dy shërbimet.

Në treg gjenden lehtësisht shoqëri të ruajtjes që ofrojnë njëkohësisht ruajtjen me punonjës shërbimi sipas kategorise 1.3.A dhe shoqërimin e vlerave monetare sipas kategorisë 1.3.B.

A. Minerali

## III. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* ***duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar,*** *ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

"Ruajtja e objekteve të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A, me punonjës shërbimi, sistem alarmi, kamera dhe ruajtja e shoqërimi i vlerave monetare "**– me afat 12 muaj,** si më poshtë vijon:

| **Nr.** | **Objekti** | **Adresa** | **Ruajtja** |
|---|---|---|---|
| 1 | Stacioni i Pompave Turan (SPT) | Rruga Korçë-Voskopojë, pranë fshatit Turan. | 1 vend roje me shërbim 24 orë. + kamera |
| 2 | Depo e ujit nr.1 | Unaza e kodrave, pranë kishës së Shën Thanasit | 1 vend roje me shërbim 24 orë. + kamera |
| 3 | Depo e ujit nr.3 | Unaza e kodrave, pranë kishës së Shën Thanasit | 1 vend roje me shërbim 24 orë. + kamera |
| 4 | Zyrat e Administratës | Blloku i Ri i Sportit, Unaza Veriore Korçë | 1 vend roje me shërbim 24 orë. + kamera |
| 5 | Impjanti i Trajtimit të Ujrave të Përdorura (ITUP) | Superstrada Korçë-Kapshticë, tek Përroi i Barçit | 1 vend roje me shërbim 24 orë. + kamera |
| 6 | Zyra e Marrëdhënieve | Rruga "Edit Durham" Korçë | 1 vend roje me shërbim 8 orë, turni i parë (ora 8:00-16:00) vetëm në ditët zyrtare të punës (nga e hëna në të premte), si dhe ditën e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | me Konsumatorin (ZMK) | | shtunë nga ora 8.00- 12.00 (gjithmonë me përjashtim të festave zyrtare) + 1 sistem alarmi + kamera + shërbimi : "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, gjatë transportit (nënkategoria 1.3.B ). nga Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), në banka të nivelit të dytë, me automjet të blinduar sipas Kategorisë A, të përcaktuar nga Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 05.03.2018 ”Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” , Kreu VI , gërma "C", pika 1, shkronja "a”. |
| 7 | Depo e ujit nr.2 | Unaza e kodrave, pranë kishës së Shën Thanasit | 1 sistem alarmi + kamera |
| 8 | Pusi 502 | Rruga Korçë-Voskopojë, pranë fshatit Turan. | 1 sistem alarmi + kamera |
| 9 | Pusi 504 | Rruga Korçë-Voskopojë, pranë fshatit Turan. | 1 sistem alarmi + kamera |
| 10 | Pusi 505 | Rruga Korçë-Voskopojë, pranë fshatit Turan. | 1 sistem alarmi + kamera |
| 11 | PZ2 | Pusetë kryesore manovrimi në rast difekti (PZ2), adresa: kryqëzimi Unaza –Rruga e Voskopojës. | 1 sistem alarmi |
| 12 | Depo Uji Bulgarec | Bulgarec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 13 | SW03 | Rezervuari përpunues i ujrave të shiut SW03, adresa: në fund të Rr. “Niko Kovaçi”, Zona e Stefanecit | kamera |
| 14 | Stacioni i pompimit Porodinë | Porodinë | 1 sistem alarmi+ kamera |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 15 | Stacioni i pompimit Barç | Barç | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 16 | Stacioni i pompimit Mborje | Mborje | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 17 | Stacioni i pompimit Gorna Gorica | Gorna Gorica , Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 18 | Stacioni i pompimit Dollna Gorica | Dollna Gorica , Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 19 | Stacioni i pompimit Tuminec | Tuminec , Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 20 | Depo e ujit Tuminec | Tuminec, Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 21 | Depo e ujit Pustec | Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 22 | Stacioni i pompimit Zernosko | Zernosko , Pustec | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 23 | Depo 1 | Bilisht , Devoll | 1 vend roje me shërbim 8 ore turni 3 + 1 sistem alarmi+kamera |
| 24 | Depo 2 | Bilisht , Devoll | sistem alarmi+kamera |
| 25 | Depo Bitinckë | Bitinckë, Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 26 | Stacioni i pompimit Bitinckë | Bitinckë, Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 27 | Depo e ujit Stropan | Stropan, Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 28 | Depo e ujit Cangonj 2 | Cangonj, Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 29 | Depo e ujit Mançurisht | Mançurisht, Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 30 | Depo e ujit Rakicke | Rakicke , Devoll | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 31 | Depo Erseke | Rehove , Kolonjë | 1 vend roje me shërbim 8 ore turni 3 + 1 sistem alarmi+kamera |
| 32 | Depo e ujit Maliq | Maliq | 1 vend roje sherbim 8 ore turni 3 + kamera+ sistem alarmi |
| 33 | Stacion pomimi Bulgarec | Bulgarec , Maliq | kamera+ 1 sistem alarmi |
| 34 | Stacion pompimi Sovjan | Sovjan , Maliq | kamera+1 sistem alarmi |
| 35 | Stacion pompimi Plasë | Plasë , Maliq | kamera+ 1 sistem alarmi |
| 36 | Stacion pompimi Mancurisht | Mancurisht , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 37 | Stacion pompimi Shengjergj | Shengjergj , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 38 | Stacion pompimi Kishnik | Kishnik , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 39 | Stacion pompimi Bregas | Bregas , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 40 | Stacion pompimi Zvirine | Zvirine , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 41 | Stacion pompimi Qesaratë | Qesaratë , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 42 | Stacion pompimi Leminot | Leminot , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 43 | Stacion pompimi Kakac | Kakac , Maliq | kamera |
| 44 | Stacion pompimi Zvirinë | Zvirinë Veliterne , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 45 | Depo e ujit Sheqeras | Sheqeras , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |
| 46 | Depo e ujit Vreshtas | Vreshtas , Maliq | 1 sistem alarmi+ kamera |

**Pra në total kërkohen :**
**5 vend roje me shërbim 24 orë +**
**1 vend roje me shërbim 8 orë turni i parë si dhe e shtunë ora 8.00-16.00 +**
**3 vend roje me shërbim 8 orë turni i tretë+**
**39 sisteme alarmi +**
**45 kamera +**
**shërbimi: "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, gjatë transportit nga Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), në banka të nivelit të dytë"**

Sistemet e alarmit dhe kamerat , kërkohet që shoqëria e ruajtjes të kryejë blerjen dhe instalimin e tyre me kostot e veta, pasi fondi përfshin vetëm koston e shërbimit . Shërbimi i ruajtjes me roje private do të kryhet 24 orë në ditë me tre turne.

Tek Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) shërbimi i ruajtjes me roje private do të kryhet 8 orë në ditë (ora 8:00-16:00) me nje turn, nga e hëna në të premte dhe ditën e shtunë nga ora 8:00-12:00 , vetëm në ditet zyrtare të punës.

Tek Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK) shërbimi i ruajtjes me roje private të nënkategorisë 1.3.B do të kryhet 8 orë në ditë (ora 8:00-16:00) me një turn (përfshirë edhe transportin deri në banka të nivelit të dytë) nga e hëna në të premte, vetëm në ditët zyrtare të punës. Ofertuesi duhet të sigurojë ruajtjen e vlerave në arkat e ZMK, transportin dhe shoqërimin e vlerave monetare që i janë besuar dhe të sigurojë jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është shoqërimi i sigurt i vlerave monetare dhe punonjësve nga ZMK, drejt filialeve të bankave të nivelit të dytë respektive.

A. Minerali

**Pra në total kërkohen 5 vend roje me shërbim 24 orë + 1 vend roje me shërbim 8 orë turni i parë +3 vend roje me shërbim 8 orë turni i trete + 39 sisteme alarmi në rrugë + 45 kamera.**

**Ofertuesi duhet të instalojë me kostot e veta sistemin e alarmit.**

Kërkohet gjithashtu që në objektet e UKRK Sh.A të bëhet vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë si masa shtesë të sigurisë publike për UKRK Sh.A, në përputhje me Ligjin Nr. 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike" dhe me Udhëzim Nr. 134, datë 10.3.2017 "Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre", udhëzim i cili percakton se: "1. Subjektet publike/private, të cilat në varësi të aktivitetit që kryejnë dhe vlerësimit të riskut nga Policia e Shtetit, që detyrohen të marrin masa shtesë sigurie dhe niveli/lloji i tyre klasifikohen si më poshtë:

1.9 Subjektet që administrojnë ujësjellësit, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje të hyrje/daljet të objektit dhe në ambientet e jashtme.

b) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

3. Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave dhe të pajisjeve të teknologjisë në të gjithë objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, bëhen nga subjekte të regjistruara në Regjistrin Kombëtar Tregtar dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit. "

A. Minerali

| Numri i Vendrojeve **24 oresh** | Numri i turneve | Numri i rojeve te nevojshme | Afati i levrimit |
|---|---|---|---|
| **5** | **3** | **5x 4.98=24,9** | **12 muaj** *Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.* |

| Numri i Vendrojeve 8oreshe, turni i pare | Numri i turneve | Numri i rojeve te nevojshme | Afati i levrimit |
|---|---|---|---|
| **1** | **1** | **1,31** | **12 muaj** *Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.* |

| Numri i Vendrojeve 8 oreshe turni i trete | Numri i turneve | Numri i rojeve te nevojshme | Afati i levrimit |
|---|---|---|---|
| **3** | **1** | **3x 1,66=4,98** | **12 muaj** *Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.* |

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj ( i parashikuar)

*Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.*

A. Minerali

**Objektivat**:
-Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të institucionit.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

**Detyrat:**

Punonjësit e shërbimi të Shoqërisë Private të Ruajtjes fituese duhet:

1. Të bëjnë ruajtjen ruajtjen e objekteve të UKRK Sh.A, në të gjithë territorin e tyre dhe të pajisur me armë, me radio për komunikim me sallën operative të drejtimit e drejtuesin e shoqërisë, uniformë dhe dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre, për 24 orë në ditë, me tre turne.\

2. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

3. Të ruajnë me përkushtim objektet që u besohen duke parandaluar vjedhjet, dëmtimet, të ruajnë rendin si dhe të sigurojnë jetën e punonjësve që punojnë në to.

4. Të ushtrojnë kontrolle të herë pas hershme në objektet e sipërpërmendur, për të parandaluar veprimet e kundërligjshme.

5. Të mos lejojnë futjen e personave në objekt pa fletë-hyrje.

6. Të mos lejojnë hyrjen dhe daljen e materiale nga objekti pa dokumentin përkatës.

7. Për persona të jashtëm që vijnë për probleme pune, duhet të njoftojnë më parë punonjësin që kërkohet dhe me lejën e tij i shoqërojnë tek ai.

8. Të kërkojnë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.

**Sistemi i alarmit** duhet të jetë , i garantuar dhe të funksionojë pandërprerje (24 orë), gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Çdo punonjës i shërbimit, titullari i subjektit të SHPSF-së, si dhe drejtuesi teknik duhet të kryejnë me pergjegjesi te gjitha detyrat e përcaktuara në Ligjin Nr. 75/2014 'Për shërbimin privat të sigurisë fizike", si dhe në aktet nënligjore.

**Detyrat e kontraktorit:**
Kontraktori ka për detyrë:
- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t’ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.

A. Minerali

- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të sherbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast te cënimit të institucionit ose të personelit.

Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendëshme të institucionit
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
- Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjësin e tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësin e rojeve dhe përgjegjësin e shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjësin e rojeve dhe përgjegjësin e shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëhere organet kopetente
- Të jetë i paisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qendrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojes, gjatë kohës së sherbimit i ndalohet të pijë pije alkolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.
- Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

**Vendi i kryerjes se sherbimeve:**

- Zyrat e Administratës së UKRK Sh.A, adresa Blloku i Ri i Sportit, Unaza Veriore Korçë.
- Depot e ujit (nr.1, nr.2 dhe nr.3), adresa Unaza e kodrave, pranë kishës së Shën Thanasit.
- Stacioni i Pompave Turan (Stacioni Kryesor dhe Puset), adresa Rruga Korçë- Voskopojë, pranë fshatit Turan.
- Rezervuari përpunues i ujrave të shiut SW03, adresa: në fund të Rr. "Niko Kovaçi", Zona e Stefanecit.

A. Minerali

- Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin (ZMK), adresa Rruga “Edit Durham” Korçë.
- Pusetë kryesore manovrimi në rast difekti (PZ2), adresa: kryqëzimi Unaza –Rruga e Voskopojës.
- Impjanti i Trajtimit të Ujrave të Përdorura (ITUP), adresa: Superstrada Korçë- Kapshticë, tek Përroi i Barçit.
- Stacioni i pompave Bulgarec
- Stacioni i pompimit Porodinë
- Stacioni i pompimit Barç
- Stacioni i pompimit Mborje
- Zerat 17-46 si ne tabelen me lart .

Kontrata ndërmjet palëve për kryerjen e shërbimeve nga SHPSF-të do të përmbajë:

a) Nënkategorinë e licencës, drejtuesin teknik dhe objektet konkrete në ruajtje.

b) Mënyrën e ruajtjes së objektit, duke specifikuar llojin e shërbimit (me punonjës shërbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, me kamera sigurie, me kombinim të mënyrave të mësipërme etj.).

c) Numrin e vendrojave kur objekti ruhet me roje dhe numrin e punonjësve të shërbimit, si dhe skemat e ruajtjes së objektit.

d) Rregulloren e brendshme të institucionit/ subjektit ku të përcaktohen rregullat për regjimin e hyrje/daljeve në objekt, ndriçimin, rrethimin dhe mjetet vëzhguese e sinjalizuese.

e) Trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit të SHPSF-së, duke përcaktuar detyrimin që paga të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

f) Skemën e ruajtjes së objekteve, së bashku me planin e dislokimit, kur merren në ruajtje objekte. Skema e ruajtjes dhe plani i dislokimit përgatiten nga drejtuesi teknik i SHPSF-së.

g) Llojin e armatimit, pajisjet, mjetet e shërbimit, uniformën, simbolet dhe shenjat dalluese.

h) Detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit.

i) Detyrat dhe të drejtat e palëve.

j) Kohëzgjatjen e kontratës dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.

Drejtuesi teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë. Ai përgjigjet për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e kryerjes së shërbimit nga punonjësit e SHPSF-së.
Drejtuesi teknik planifikon shërbimet për ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe përpilon skemat e ruajtjes, si dhe plane të veçanta për ruajtjen e tyre për situata emergjente.
Drejtuesi teknik **ose** përgjegjësi i shërbimeve për çdo objekt në ruajtje mban dhe plotëson rregullisht librin e planëzimit të shërbimit dhe librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit.

A. Minerali

Në librin e planëzimit të shërbimit shënohen punonjësit e shërbimit sipas objekteve, vendrojave, oraret e shërbimit, ditët e pushimit javor dhe vjetor.

Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike për kryerjen e detyrave të ngarkuara vepron me cilësinë e rojës, operatorit, shoferit, verifikim sinjali, shofer, si dhe të përgjegjësit të shërbimit.

Shoqëria private e sigurisë fizike, për realizimin e detyrës, në varësi me specifikat e shërbimit pajis punonjësit me armatim personal, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 74/2014 "Për armët" me ndryshime.

A. Minerali